

KËSHILLA DHE SUGJERIME PËR TË PUNUAR NË SIGURI



SIGURIA *në punë!*

Bashkë-financohet nga:



BASHKIMI
EVROPIAN



DEPARTAMENTI I ZJARRFIKËSVE
TË NDHËMËS PUBLIKE
DHE MBROJTJES CIVILE



MINISTRIA
E BRENDSHME

Fondi Evropian për Integrimin e Qytetarëve të Vendeve të Treta

SIGURIA *në punë!*

Hyrje	
Industria e ndërtimit	5
Agrikultura	21
Punët shtëpiake	37
Rreziku kimik	49
Pajisjet e mbrojtjes individuale dhe sistemi i shenjave të sigurisë ...	53
Aksidenti dhe sëmundja profesionale: çfarë duhet bërë?.....	60
Glosari	62
Normativa e referimit.....	63

Hyrje

Dekreti legjislativ 626/94, i ndryshuar nga dekreti legjislativ n. 81/08, i cili rirregullon në një tekst të vetëm dhe organik të gjitha normat dhe dispozitat që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve, ka qëllim që të ofrojë disa linja udhëzuese për përcaktimin e një “sistemi parandalues” në vendet e punës.

Ky sistem, që të funksionojë në mënyrë efektive, para së gjithash ka nevojë për një ndërgjegjësim në lidhje me problemin e sigurisë në të gjitha nivelet, në mënyrë që aktiviteti i parandalimit dhe i mbrojtjes nga rreziqet të mos jetë më i huaj dhe i largët nga realitetet e punës së çdo dite, por përkundrazi, të jetë pjesë integrale e proceseve normale të organizimit të punës.

Në sektorin e sigurisë në vendet e punës është e nevojshme që të sensibilizojmë punëdhënësin me qëllim që të perceptojë sigurinë “si një investim dhe jo si një shpenzim” (aksidentet në punë sjellin kosto shumë të larta të shpenzimeve sociale-ekonomike). Punëtori, nga ana tjetër, nuk duhet të konsiderohet më si një figurë pasive që zbaton udhëzimet që i jepen, por një subjekt i vërtetë aktiv, aftësitë dhe njohuritë e të cilit janë të domosdoshme për realizimin e një sistemi të vlefshëm që ka si pikësynim sigurinë dhe shëndetin në punë.

Duke pasur parasysh se “siguria në punë” duhet të jetë përgjegjësi e të gjithëve dhe se analiza statistikore e përbashkët ISTAT-INAIL, në lidhje me vitin 2010, ka nxjerrë në pah se nga 4 milionë të huaj që janë të pranishëm në Itali (rreth 6.5% e banorëve rezidentë) më shumë se 3 milionë janë punëtorë të siguruar INAIL (Instituti kombëtar për sigurimin kundër aksidenteve në punë) dhe pasi është rilevuar se 16.4% e aksidenteve ka përfshirë një emigrant, është konsideruar si themelore një ndërhyrje për të përhapur, sidomos ndërmjet punëtorëve emigrantë, parimet, madje edhe ato më fillestaret, për sigurinë në vendet e punës, për të rritur aftësitë e secilit për vetëmbrojtje dhe solidaritet shoqëror.

INDUSTRIA E NDËRTIMIT

Sektori i ndërtimeve duket se nuk e njeh krizën në lidhje me numrin tragjik të vdekjeve në punë: 196 vdekje të denoncuar në vitin 2009, 3% më shumë se në vitin 2008.

Ata që mbeten viktimë të aksidenteve, në pothuajse të gjitha rastet, janë meshkujt e moshës ndërmjet 35 dhe 49 vjeçare. Përafërsisht 21% e të gjitha aksidenteve dhe një rast vdekje në gjashtë ka lidhje me punëtorët e huaj të sektorit.

Në ndërtim, shkaku më i shpeshtë i aksidenteve rezulton në humbjen e kontrollit të pjesshëm ose të përgjithshëm të mjetit dhe/ose të pajisjeve për zhvendosje (29%), e pasuar nga rrëzimet ose rrëshqitjet e personit të aksidentuar (25%), që në veçanti i llogarit rrëzimet nga lartësia me një rezultat prej 9% të aksidenteve. Si konfirmim i rrezikut të lartë lidhur me rrëzimet nga lartësitë, përveç numrit të madh, janë pasojat e rënda që shoqërohen me to.

Nuk duhet të nënvlerësohen, më në fund, të gjitha ato aktivitete "e bëj vetë", që një privat mendon se mund të realizojë vetë. Edhe një mirëmbajtje rutinë, në pamje operacioni i lehtë, mund të fshehë rreziqe e madje vdekjeprurëse.



RRËZIMET DHE RRËSHQITJET

Punonjësve të punësuar në kantieret e ndërtimit, u ndodh çdo ditë që të punojnë “në lartësi”. Për të garantuar sigurinë, për të parandaluar rënien nga lart jo vetëm të punëtorëve, por edhe të materialeve që mund të plagosin ose të dëmtojnë persona ose sende në hapësirën e kantierit, përdoren pajisje mbrojtëse si kolektive ashtu edhe individuale. Pajisjet kolektive që përdoren kur punohet në lartësi janë “vepra të përkohshme” të realizuara sipas karakteristikave të veçanta të ligjit dhe që përfshijnë struktura të tilla si skela ose parrmakë.

Kur punohet në lartësi, është e domosdoshme të përdorim në mënyrë korrekte Pajisjet Mbrojtëse Individuale, PMI (Dispositivi di Protezione Individuale - DPI) të duhura. Është e nevojshme të përdorim rripin ose sistemin e rripave të sigurimit dhe pika të përshtatshme dhe të sigurta të ankorimit. Për përdorimin e pajisjeve të tilla është e detyrueshme të ndjekim kurset e formimit dhe përgatitore. Nëse punohet mbi një çati është e detyrueshme që të shtrojmë mbi të dërrasa që do të përdoren si sipërfaqe mbështetëse për të ecur mbi to; por duhet, gjithashtu, të vendosim nën çati, një skelë ose një rrjetë sigurie. Nëse përdoren skela, për t'u ngjitur duhet të përdorim gjithmonë shkallët. Duhet shmangur kacavarjet.

Në kantieret e ndërtimit, për të kufizuar rrezikun e rënies së materialeve nga lart është e nevojshme që të ndalojmë hyrjen e të huajve (personave të paautorizuar) duke përcaktuar zonën e punës. Për skelat, duhet të instalohen bordurat mbrojtëse kundra gurëve ose rrjetat kundra rënies. Punëtorët e ndërtimit, për të vepruar në tokë ose brenda ndërtesave, përdorin skela me rrota ose ura mbi këmbalecë. Për të zvogëluar rrezikun e rënies nga lart, duhet të sigurohemi që skelat ose urat mbi këmbalecë të jenë të bazuara në një mbështetje të fortë dhe të qëndrueshme nëpërmjet një baze të

përshtatshme. Gjatë përdorimit të skelave me rrota, rrotat e urës duhet të bllokohen me pykën e duhur. Duhet shmangur lëvizja e skelave (platformave), kur ata janë të mbingarkuara dhe kur punëtorët janë mbi ta.

Duhet përdorur në mënyrë korrekte shkallët me dorë dhe duhet shmangur përdorimi i shkallëve me defekt ose me pjesë të dëmtuara. Kundër rrezikshmërisë së rrëshqitjes, sigurohuni që fundet e poshtme të shtyllave mbajtëse të jenë të pajisura me pajisje kundër rrëshqitjes dhe ato të sipërmet të kenë kanxhat mbajtëse apo mbështetëse kundër rrëshqitjes.



KUJDES!

Çdo skelë duhet të shoqërohet nga një broshurë e cila përmban përshkrimin, udhëzimet, skemat për montimin dhe kushtet e përdorimit. Broshura duhet të jetë gjithmonë e pranishme në kantier. Skela duhet të mbahet në gjendje të mirë pune dhe duhet t'i nënshtrohet kontrollit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, sidomos pas motit të keq. Operacionet e montimit, çmontimit dhe transformimi i një skele duhet të kryhet vetëm nga një personel i kualifikuar dhe nën mbikëqyrjen e kujdesshme të një personi përgjegjës të emëruar për këtë qëllim.



Mungesa e vëmendjes në vendin e punës mund të ketë pasoja serioze, madje fatale.

MJETET E LËVIZSHME TË PUNËS

Cektësia, pakujdesia dhe mungesa e zbatimit të rregullave më elementare të sigurisë janë shkaku kryesor i aksidenteve, me pasoja pak a shumë të rënda, që përfshijnë punëtorët e punësuar në përdorimin e pajisjeve të punës të lëvizshme ose vetëlëvizëse.

Kur përdoren këtë lloj pajisjesh në një kantier ndërtimi, duhet të respektohen rregullat e qarkullimit, të cilat duhet të jenë të vendosura nga përgjegjësi i sigurisë.

Nëse përdoren pajisje të lëvizshme për transportin ose punën e punëtorëve, të tilla si platformat ngritëse të punës, duhet të sigurohemi që përdorimi të bëhet vetëm në vende të sigurta dhe se shpejtësia e pajisjeve të jetë e përshtatshme.

Është e nevojshme të kontrollojmë që punëtorët të mos gjenden në zonën operative të pajisjeve vetëlëvizëse të punës ose, në qoftë se prania e tyre është e nevojshme, të mos pësojnë dëme nga lëvizja e mjeteve.



Punëtorët duhet t'i përdorin pajisjet sipas informacionit dhe formimit të marrë, nuk duhet t'i bëjnë atyre modifikime të çfarëdo lloji dhe duhet menjëherë të raportojmë tek personi i ngarkuar epror çdo anomali ose problem që mund të paraqesin.

Drejtuesit mjeteve të lëvizshme të punës duhet të veshin rroba të përshtatshme për punë. Në përgjithësi, janë të këshillueshme një tutë, që lejon liri të plotë të lëvizjes, dhe këpucë të lehta me shtroje gome.

Është e përshtatshme, në rastin e përdorimit të platformave ajrore, që veglat e punës dhe çdo mjet tjetër të vendosen aty ku duhet, në mënyrë që të mos bien dhe të mos shkaktojnë aksidente.

KUJDES!

Adoptimi i të gjitha masave të sigurisë dhe të masave parandaluese që jepen nga konstruktori në manualin e përdorimit të pajisjeve, zvogëlon rrezikun e aksidenteve dhe të fatkeqësive.



NGRITJA E NGARKESAVE

Në një kantier ndërtimi ose në një zonë porti lëvizën dhe ngrihen vazhdimisht materiale të ndryshme. Zhvendosja dhe ngritja e ngarkesave mund të bëhet me pajisje të dedikuara ose me dorë.

Gjatë përdorimit të pajisjeve për ngritjen e ngarkesave duhet të bëhet një hetim paraprak i zonës ku do të shkojmë për të punuar, kontrollojmë që terreni t'i garantojë stabilitet mjetit dhe që distancat minimale të sigurisë nga linjat elektrike ajrore të respektohen gjithmonë.

Për të reduktuar rreziqet duhet të kontrollojmë që pajisjet për ngritjen të jenë efikase dhe të mos kenë pësuar dëmtime, të kontrollojmë gjendjen e konsumimit të litarëve, kanxhave ose të zinxhirëve; të verifikojmë periodikisht sistemet e ngritjes dhe të përjashtojmë ato që janë me anomal.

Pajisjet për ngritje duhen zgjedhur në funksion të ngarkesës që do të zhvendoset. Gjithmonë duhet të sigurohemi që ngarkesat të jenë të lidhura



mirë dhe të balancuara para çdo operacioni tjetër. Duhet shmangur manovrat që mund të shkaktojnë përplasje ndërmjet ngarkesave ose elementëve të pajisjeve.

Gjatë përdorimit të pajisjeve, duhet të kemi kujdes për të mos lëvizur ngarkesa mbi hapësirat e punës ose në rrugët e lëvizjes. Punëtorët gjatë pritjes, duhet të jenë të kujdesshëm për të mos qëndruar nën ngarkesat pezull dhe duhet të kenë mundësi të mbërthejnë dhe të çlirojnë me dorë një ngarkesë duke pasur siguri të plotë.

Lëvizja manuale e ngarkesave (lmn)

Me anën e këtij termi kuptohen të gjitha ato operacione që kryejnë një ose më shumë punëtorë për të ngritur, transportuar, zhvendosur, shtyrë, tërhequr ose ulur një ngarkesë. Rezulton menjëherë e qartë se në lmn (mmc – movimentazione manuale dei carichi), marrja e një qëndrimi trupor të përshtatshëm dhe një vlerësim i duhur i peshës që do të ngrihet kanë një rëndësi të thelloret.

Për të ngritur ngarkesat në mënyrë korrekte, duke shmangur ngacmimet e tepërta të shtyllës

KUJDES!

Gjatë përdorimit të rripave të sigurimit me litarë metalikë, përdorni në mënyrë korrekte PMI (DPI) të parashikuara (doreza mbrojtëse, këpucë kundër aksidenteve dhe helmët). Gjithashtu, në qoftë se përdorni pajisje për ngritjen, duhet të keni kujdes që shenja CE (BE) të jetë gjithmonë e dukshme dhe emri i prodhuesit dhe treguesi i ngarkesës maksimale të jenë të lexueshëm. Frekuenca dhe kohëzgjatja e lëvizjes; kushtet; lartësia nga toka e peshave për t'u ngritur ose lartësia e mbërritjes së ngarkesës; rrotullimi i trunqut apo zhvendosja vertikale e ngarkesës; janë të gjithë faktorë që ndikojnë ose që kontribuojnë në shkakun e rastësishë së aksidenteve për shkak të lmn.

kurizore, duhet të mos harrojmë që të përkulim këmbët duke mbajtur shpinën drejt dhe duke i mbajtur këmbët të mbështetura mirë në sipërfaqen e tokës. Pështja që do të ngrihet, për më tepër, duhet të jetë sa më afër të trupit.

Mosrespektimi i rregullave të thjeshta gjatë zhvendosjes së ngarkesave madje edhe të lehta, mund të çojë në çrregullime të rënda të sistemit muskulo-skeletal.

PËRDORIMI I MAKINAVE

Janë të shumëllojshme makinat që përdoren në një kantier ndërtimi; kështu që edhe rreziku për të pësuar aksidente nga ndonjëra prej tyre ngjan i shumëfishtë. Çdo makinë paraqet rreziqe specifike (rrezik elektrik, zhurmë, kontakt me pjesët e makinës, rrezik të cungimit apo të shtypjes së gjymtyrëve, etj.). Prandaj është e rëndësishme që t'i njohim mirë ata në mënyrë që të marrim masat e duhura parandaluese.

Përdorni makinën vetëm për aktivitetet për të cilat është projektuar. Mos hiqni mbrojtëset dhe sinjalizoni menjëherë çdo anomali të mundshme ose çdo situatë rrezikshmërie.

Është një zakon shumë i mirë që të verifikojmë funksionimin e përsosur të çelësit të manovrës ose të butonit të emergjencës, integritetin e kabllove të energjisë dhe efikasitetin e mekanizmave të sigurisë.

Duke punuar pranë një makine në veprim supozohet se duhet të njohim disa rregulla që ndihmojnë për të vepruar në mënyrë të sigurt. Çdo punonjës duhet të jetë i vetëdijshëm se duke pasur këto njohuri ai mbron pacenueshmërinë e vet dhe atë të kolegëve të tij.

Gjatë përdorimit të një betoniere, për shembull, duhet të jeni të kujdesshëm gjatë operacioneve të ngarkimit, që të mos fusni duart, lopatën ose vegla të tjera pune në brendësi të kazanit. Përdorni një palë tuta pune të përshtatshme që të mos kenë lidhëse, xhepa apo ndonjë gjë tjetër që mund të ngatërrohet në ingranazhet e makinës dhe sigurohuni që makina të jetë plotësisht e ndaluar, përpara se të filloni me punimet e pastrimit.

KUJDES!

Çdo makinë ka manualin e vet të përdorimit dhe të mirëmbajtjes që jep të gjithë informacionin në lidhje me përdorimin korrekt, rreziqet, masat parandaluese që duhen adoptuar dhe PMI (DPI) që janë të detyrueshme të vishen.

Ndiqui udhëzimet që jepen nga manuali edhe për të gjithë operacionet e mirëmbajtjes dhe konsultojeni atë në rast të dyshimeve në lidhje me përdorimin korrekt të makinës.

Gjatë përdorimit të pajisjeve të tilla si makinat hekurkthyes duhet pasur kujdes për të mos afruar duart tek pjesët në lëvizje të makinës, ashtu siç duhet pritur kur makina të jetë ndaluar krejtësisht, për të bërë rregullime ose pastrimin e saj.

Pajisjet që paraqesin rreziqe të shumta në përdorimin e tyre janë sharrat disk. Mos harroni të mbani duart larg nga ana e tehut dhe asnjëherë nuk duhet të braktisni vendin e punës kur makina është në funksionim, për të zvogëluar rrezikun e prerjeve apo të gjymtimeve. Përpara se të bëni një prerje, verifikoni që sistemi i mbrojtjes së tehut të jetë i vënë në funksion. Përdorni një mjet zëvendësues për të sjellë copat e vogla në procesin e prerjes.



Duke punuar pranë një makine në veprim supozohet se duhet të njohim disa rregulla që ndihmojnë për të vepruar në mënyrë të sigurt. Çdo punonjës duhet të jetë i vetëdijshëm se duke pasur këto njohuri ai mbron pacenueshmërinë e vet dhe atë të kolegëve të tij.



RREZIKU ELEKTRIK

Në një kantier energjia elektrike gjen një përdorim pothuajse total. Ky përdorim në mënyrë masive e ekspozon punëtorin ndaj një game të gjerë të rreziqeve. Në Itali, që nga vitet nëntëdhjetë, është nisur një rrugë normative e cila ka çuar deri në dekretin n. 37 të datës 22 janar 2008 - në lidhje me normat e sigurisë së impianteve - në të cilat është theksuar se si instalimet e impianteve dhe të aparaturave të pranishme në vendin e punës duhet të përmbushin norma të sakta ligjore dhe të instalohen vetëm nga një personel i kualifikuar dhe i certifikuar.

Ndërgjegjësimi dhe njohuritë e rrisin pragun e vëmendjes, kur gjendemi në vendin e punës dhe ndihmojnë operatorin për të parandaluar rreziqet e mundshme që lidhen me energjinë elektrike.

Në përgjithësi, rreziqet që lidhen me rrymën elektrike ndodhin



për shkak të kontaktit direkt dhe të kontaktit indirekt. Kontakti direkt (i drejtpërdrejtë) ndodh kur, për shembull, preken dy tela të zhveshur. Mbrojtja kundër kontakteve direkte bëhet me anë të izolimit, mbështjellësve dhe barrierave.

Kontakti indirekt ndodh kur preken pjesët e një aparati të cilat, për shkak të një defekti të brendshëm dhe që ka komprometuar izolimin, i nënshtrohen tensionit. Mbrojtjet kundër kontakteve indirekte janë të ashtuquajturit çelës “salvavita” (shpëtues-jete).

Kuadrot BSK (ASC)

Në të gjitha kantieret — nga ato tepër të vegjlit që kryejnë punë të thjeshta të mirëmbajtjes apo ristrukturime modeste, deri në ato të mesme ose të mëdha, — duhet të jenë gjithnjë të pranishëm kuadrot “Bashkime të Serisë për Kantier” (BSK), “Assiemati di Serie per Cantiere” (ASC). Janë BSK që shpërndajnë energjinë elektrike për nevojat e ndryshme të kantierit.

Kuadrot BSK janë një nga komponentët thelbësorë të sigurisë; ata nuk janë objekt i punës së elektricistëve të zakonshëm, por blihen të montuar paraprakisht, të kolauduar dhe të certifikuar nga konstruktori.

Prizat, duke parë kushtet e veçanta të punës në një kantier ndërtimi, duhet të përdoren sipas rregullave të sakta dhe normave të veçanta që parashikohen me ligj. Në veçanti, ata duhet të mbrohen nga mbingarkesat nëpërmjet çelësave përkatës së sigurisë.

KUJDES!

Shkaku më i shpeshtë i aksidenteve në kantieret e ndërtimit varet nga defektet e pajisjeve elektrike. Prandaj është e nevojshme që pajisjet të përdoren ashtu siç duhet, me kujdes, duke ndjekur me përpikëri udhëzimet e dhëna nga konstruktori. Për më tepër, duhet të sinjalizohet menjëherë çdo mosfunksionim ose defekt që mund të ndeshet.



Implantet elektrike të pranishëm në vendin e punës duhet të jenë të taruar nga ndërmarrjet që japin një certifikatë të implantit me “mjeshhtëri”, konform me dekretin n. 37 të vitit 2008.

VIBRACIONET DHE ZHURMA

Zhvillimi progresiv i industrisë mekanike, fuqia e shtuar e makinave, përdorimi në rritje dhe gjithnjë e më i përhapur i pajisjeve vibruese ekspozon punëtorin, me pasoja pak a shumë të dëmshme për shëndetin e tij, ndaj zhurmave dhe vibracioneve në një mënyrë gjithnjë e më të shpeshtë.

VIBRACIONET

Dallohen dy lloje vibracionesh: ato që përfshijë të gjithë trupin dhe ato që ndikojnë vetëm disa pjesë të tij.

Për të zvogëluar nivelin e vibracioneve nga makinat dhe nga pajisjet, është e dobishme të pajisemi me modele të avancuara të pajisura me sisteme që absorbojnë vibracionet dhe t'i ruajmë gjithmonë në gjendje të mirë të mirëmbajtjes. Edhe përdorimi i PMI (DPI) kontribuon në zvogëlimin e efekteve të vibracioneve në pjesët e përfshira të trupit.

Pasojat për sistemin dorë-krah, për shkak të vibracioneve të pësura, pa masat parandaluese të duhura, janë zbehje dhe dhimbje të gishtave të dorës, ndjesi pickimi, dhimbje në nyajt e dorës, të kyçit, të bërrylit ose të shpatullave. Ato të shkaktuara nga ekspozimi ndaj vibracioneve që i transmetohen krejtësisht trupit, pa masat e duhura, mund të çojnë në dhimbje të shpinës dhe të qafës.

ZHURMA

Zhurma mund të përkufizohet, me një përafërsi të mirë, si një zë që ndikon negativisht në mirëqenien fizike dhe mendore të punëtorit. Zhurma, edhe pse nuk ka efekte të dukshme ose që mund të vërtetohen menjëherë, mund të

çojë në dëme të pakthyeshme të dëgjimit (ulje të pragut dëgjimor deri në shurdhëri të plotë) ose dëme të natyrës psikofizike.

Ulja e nivelit të zhurmës në vlera të pranueshme direkt në burim është gjëja e parë për t'u bërë në përpjekje për të reduktuar rreziqet. Veprime të dobishme janë, për shembull, një mirëmbajtje korrekte ose një izolim i përshtatshëm i pajisjes.

Në mbështetje të veprimeve që kanë qëllim uljen e intensitetit të zhurmës janë, përveç kësaj, PMI specifike, të përcaktuara si mbrojtësit e veshit, si tapat (ose aurikular) dhe kufjet.

KUJDES!

Dekreti Legjislativ 81/08 përcakton se çfarë duhet të nënkuptohet me rrezikun me prejardhje nga vibracioni (dridhja), si për të gjithë trupin ashtu edhe për sistemin dorë-krah; kufirin e kohës për ekspozimin ditor për punë; cilat janë vlerat e veprimit dhe të ekspozimit ndaj zhurmave/vibracioneve përtej të cilave hyjnë në veprim detyrimet e parashikuara nga ligji.



Rreziqet me prejardhje nga dridhjet dhe zhurmat, në përgjithësi, nënvlerësohen. Në mënyrë që të parandalohet lindja e dëmeve mandje edhe të rënda në organizmin e punëtorit, duhet të përdorni përherë PMI të parashikuara dhe të respektoni limitet e ekspozimit ashtu siç janë të disiplinuar nga legjislacioni.

DEMOLIMET DHE RISTRUKTURIMET

Një aktivitet i rëndësishëm i kantierit të ndërtimit i është dedikuar demolimeve (shembjeve). Është menjëherë e qartë, madje edhe për ata që nuk janë specialistë, se si një analizë e kujdesshme e hapësirës apo e ndërtesës, që ka të bëjë me veprat e demolimit dhe marrja e masave të duhura parandaluese, ndihmon për të ulur ndjeshëm rreziqet që lidhen me aktivitete të tilla.

Pasi të jetë kontrolluar gjendja e ruajtjes dhe stabiliteti i kompleksit për t'u shkatërruar, duhet të lëvizim me kujdes, duke proceduar nga lart poshtë, e duke qenë të kujdesshëm për të mos komprometuar strukturat mbajtëse.

Përcaktojmë qartë të gjithë zonën e interesuar, me sinjalizimet e duhura për sa i përket rrezikshmërisë, dhe ndalojmë të gjitha hyrjet e personelit të pakualifikuar me anën e barrierave përkatëse.

Mos i hidhni materialet nga lart, por përdorni kanalet përkatëse. Nëse keni nevojë për të copëzuar mure apo materiale të tjera të



Asnjë vepër bonifikimi ose demolimi (rrënimi) apo heqje e materialeve që përmbajnë amiant nuk mund t'i caktohet punonjësve të përgjithshëm të ndërmarrjes, por duhet t'i drejtohem, gjithmonë, ndërmarrjeve të specializuara.

mbetura, duhet të keni kujdes t'i lagni më përpara me ujë.

Sigurohuni që të keni të gjitha pajisjet e mbrojtjes kolektive (PMK) të përshtatshme për situatën ekzistuese; përdorni gjithmonë dhe detyrimisht pajisjet mbrojtëse individuale (PMI) kundra rrëzimit dhe mbrojtëse; parashikoni përdorimin e pajisjeve të lëvizshme.



KUJDES!

AMIANTI: një rast i veçantë

Amianti (asbesti) është një mineral shumë i përhapur në natyrë i cili ka gjetur përdorim të gjerë në ndërtim në sajë të karakteristikave të tij: ai është rezistent ndaj temperaturave të larta dhe është një izolues shumë i mirë termik dhe akustik. Përkundrazi, fibrat e amiantit, të shpërndara në ajër dhe kur thithen nga njerëzit, janë **kancerogjene**.

Aktualisht, përdorimi i amiantit në ndërtesa është i ndaluar me ligj dhe impiantet e strukturat e ndërtimit në të cilat ky material është i pranishëm, duhet t'i nënshtrohen ndërhyrjeve për mirëmbajtje dhe bonifikim. Të gjitha ndërhyrjet që kanë të bëjnë me strukturat në të cilat është i pranishëm amianti ose derivatet e tij, duhet të bëhen vetëm nga personat e regjistruar në regjistrin e ndërmarrjeve që bëjnë këtë lloj ndërhyrje.

AGRIKULTURA



Shtrirja e fenomenit të aksidenteve në agrikulturë (bujqësi) ka bërë që Komisioni Evropian ta shpallë atë “sektor me rrezik të lartë”, si në aspektin e shpeshtësisë ashtu edhe të seriozitetit të aksidenteve.

Aksidentet që përfshijnë operatorët e agrikulturës (punonjësit e bujqësisë) përcaktohen shpesh herë nga një kombinim faktorësh të njëkohshëm të tillë si ambienti i punës (pjerrësia e terrenit, pengimet dhe pengesat përgjatë rrugëve etj.), operatori i agrikulturës (mungesa e aftësive dhe e përvojës profesionale, lodhja fizike dhe psikofizike, nënvlerësimi i rrezikut) makina bujqësore (vjetrimi dhe përkeqësimi, mungesa e mirëmbajtjes dhe/ose zëvendësimi i mbrojtëseve të thyera).

Në tipologjinë “aksident bujqësor” rezultojnë me një rëndësi të veçantë “sëmundjet profesionale” (në vitin 2009 +16% ndaj vitit 2008) të lidhura si me ambientin e punës ashtu edhe me materialet dhe instrumentet në përdorim të përbashkët.

Në faqet që vijojnë do të merren në konsideratë disa nga aksidentet më të shpeshta dhe do të jepen këshilla se si mund të shmangët ekspozimi ndaj rrezikshmërisë për të reduktuar mundësitë që dëmi të verifikohet.

TRAKTORI

Traktori apo tërheqësi është një automjet që mund të përdoret si fuqi për tërheqje (apo shtytëse), si një çift me një bosht rotullues (pra i destinuar të funksionojnë i çiftuar me veglat dhe makineritë bujqësore), si burim i energjisë hidraulike për komandimin dhe mbështetjen e makinave operuese.

Nga një shqyrtim i të dhënave statistikore është kollaj të arrihet në konkluzionin se në punët bujqësore, aksidentet më të shpeshta dhe shpesh vdekjeprurëse janë të lidhura me përdorimin e traktorit: njohja e rreziqeve të lidhura me përdorimin e makinës dhe përdorimi i pajisjeve të përshtatshme mbrojtëse individuale mund të ndihmojë operatorët në agrikulturë për të zvogëluar ekspozimin ndaj rrezikut.

Përmbysja e mjetit

Një nga aksidentet më të shpeshta është përmbysja (kapërdimja anësore) e mjetit që mund të shkaktohet nga manovrat e papritura në kushte të vështira, nga mbingarkesa e traktorit, nga mosbalancimi i ngarkesës ose i pajisjeve që barten.



Për të zvogëluar rreziqet e përmbysjes gjatë drejtimit të traktorit është e nevojshme që të kemi një vëmendje të madhe në fazat e ster-cimit (kthesës së shpejtë) dhe kryesisht në korrelacion me stabilitetin e terreneve.

Në rrugët në tatëpjetë, sidomos me mjetin në ngarkesë të plotë, përdorni marshet e ulët dhe mos vini në punë friksionin.

Duhet përdorur gjithmonë goma me një profil të lartë, me batistradë (pjesën shkelëse) të gjerë, me presion të ulët dhe, për të punuar në terrene kodrinore ose në terrene të lagura, duhet të preferohen traktorë me zinxhirë.

KUJDES!

Për një funksionim të mirë të traktorit janë të nevojshme, me kalimin e kohës, operacionet e mirëmbajtjes dhe të kontrollit që duhet të bëhen me periodicitetin dhe rregullsinë e nevojshme.



TRAKTORI/2

Ka në tregti lloje dhe modele të ndryshme traktorësh, në varësi të kushteve të punës dhe të fuqisë së kërkuar. Ka modele me goma, pra me rrota gome ose me zinxhirë (traktor me zinxhirë). Zgjedhja varet nga kushtet e terrenit dhe nga lloji i punimit të kërkuar.

Edhe pse projektimi dhe konstruksioni i traktorit janë studiuar për përdorim jashtë rrugëve normale, është e nevojshme që të vlerësojmë modalitetin e drejtimit në lidhje me gjendjen e rrugëve të fshatit. Në fakt, një pjerrësi e tepruar e terrenit, prania e disniveleve, e shembjeve, gropave, si dhe një rimorkio e ngarkuar me pesha të tepërta mund të përcaktojnë një ngritje arithi të mjetit (përmbysjen e pasme).

Për të shmangur këtë lloj aksidenti është e rëndësishme që kundërpeshat e përparme të jenë ato të parashikuara nga konstruktori.

Shpejtësia e punës duhet të jetë e fillë sa të ruajë sigurinë e nevojshme në lidhje me trajtën e terrenit mbi të cilën punojmë.

Është gjithashtu e domosdoshme që të verifikoni dhe të respektoni

pjerrësitë e përshkruara në "manualin e përdorimit dhe të mirëmbajtjes" së makinës, kontrolloni që ngarkesa të mos tejkalojë tërheqjen e lejuar dhe materialet të jenë të shpërndara në mënyrë të njëtrajtshme për të ruajtur stabilitetin e traktorit. Përdorni gjithmonë rimorkio të pajisura me sistem frenues.

KUJDES!

Përdorni vetëm traktorët e pajisur me kabinë mbrojtëse të vendit drejtues ose me kornizë mbrojtëse (në rastin e traktorëve të regjistruar para vitit 1974). Në mënyrë që kafazi mbrojtës i pilotit të ketë efektshmërinë e vet, sedilja (ndenjësja) duhet të jetë e pajisur me rripa sigurimi të homologuar (të miratuar).



Mos përdorni traktorë për të transportuar nëse nuk janë të homologuar posaçërisht për këtë qëllim.



DËME DHE PLAGOSJE

Në operacionet e ngjitjes dhe të zbritjes nga mjeti duhet t'i kushtohet vëmendje e madhe: pedanave të ndotura me baltë, të cilat mund të shkaktojnë rrëshqitje dhe rrëzime. Është e këshillueshme që të mbahemi mirë në dorëzat gjatë fazave të ngjitjes dhe të zbritjes, të mbajmë gjithmonë pedanat e pastruara nga balta dhe të përdorim gjithmonë këpucë kundra rrëshqitjes.

Ndërmjet plagëve më të rënda gjejmë ndër të tjera ato që shkaktohen nga boshti kardanak dhe/ose nga priza për transmetimin e fuqisë. Për këtë arsye është e rëndësishme që:

- të verifikojmë që priza e transmetimit të fuqisë (pto) dhe boshti kardanak të jenë të mbrojtur me karter (mbulesë) të përshtatshëm;
- të veshim rroba pune pa rripa dhe gjëra të ngjashme me rripat të cilat mund të mbërthehen në organet e lëvizshme:



- të shmangim ndërhyrjet afër prizës së transmetimi të fuqisë kur ajo është në lëvizje dhe mbi të gjitha nuk duhet të harrojmë se thyerja e boshtit kardanak mund të shkaktojë flakjen e materialeve që mund të shkaktojnë plagosje shumë serioze.

Për të shmangur nisje "të rreme":

- e ndezim motorin vetëm kur jemi të ulur në vendin e drejtimit (kurrë nga toka!), pasi të kemi vënë në punë frenin e parkimit;
- në rast se mjeti është në qetësi, përveç vënies në veprim të frenit të parkimit, i heqim gjithmonë çelësat për të parandaluar një vënie në funksionim aksidentale të komandave nga ana e personave të paautorizuar për drejtimin e mjetit.

Së fundi, pasi nga ekspozimi ndaj rrezikshmërisë nuk përjashtohen ata që punojnë në afërsi të një traktori, qoftë ai i ndalur apo në lëvizje, gjatë manovrimeve verifikojmë gjithmonë që të mos ketë njerëz në afërsi të makinës ose sido që të jetë përdorim sinjalizuesin akustik.



Megjithëse traktori është një mjet që ka shumë funksione ai nuk është i përshtatshëm për transportin e pasagjerëve: mund të transportohet vetëm një pasagjer dhe vetëm kur është e pranishme ndenjësja përkatëse e ndërtuar posaçërisht për këtë qëllim.



KUJDES!

RREZIK ZJARRI derdhje nafte

Gjithmonë duhet të furnizojmë makinën në një vend të sigurt, larg nga burimet e nxehtësisë dhe me motor të fikur, nuk duhet të pimë duhan.

MOTOSHARRA

Motosharra, si për sa i përket stabilitetit të vogël në të cilin mund të përdoret, si për afërsinë ndërmjet operatorit dhe zinxhirit prerës, mund të jetë shkak për plagosje serioze. Motosharra duhet të jetë e pajisur me pedal gazi me kthim automatik i cili në rast se e lëshojmë duhet të ndalë zinxhirin, edhe shkarkimi duhet të jetë i mbrojtur nga rrjetat metalike të cilat parandalojnë djegiet.

Gjatë fazës së nisjes së motosharrës:

- gjithmonë përdorni doreza mbrojtëse;
- mos harroni se pozicioni korrekt i nisjes është në tokë me frenin e zinxhirit të vënë në funksionim;
- mbajeni me forcë motosharrën me të dyja duart.

Gjatë përdorimit:

- shmangni që tehu të prekë gozhda ose gurë, mund të thyhet zinxhiri dhe të shkaktojë një kërcim të motosharrës;



Zgjidhni me kujdes pozicionin dhe vendin e përdorimit të motosharrës për të shmangur pasojat, madje shumë serioze.

- duhen veshur pajisjet mbrojtëse individuale të duhura për t'u mbrojtur nga zhurma, nga vibracionet, nga inhalacioni dhe/ose kontakti direkt me pluhura me natyrë drusore;
- duhet përdorur sistemi i sinjaleve të sigurisë nëse është e nevojshme;
- duhet punuar gjithmonë nga pozicione të qëndrueshme.

KUJDES!

Gjatë përdorimit të motosharrës është jashtëzakonisht e rëndësishme që operatori t'i përmbahet me rreptësi udhëzimeve të manualit të instruksioneve dhe të jetë në gjendje shumë të mirë fizike e me refleks të mira.



MAKINAT BUJQËSORE

Në agrikulturë përdoren makina të ndryshme. Ndër këto mund të përmendim motoplugin dhe kombajnën e sanës, të cilat janë ato që më shpesh shkaktojnë aksidente ndërmjet punëtorëve.

Motoplugu

Është një traktor i vogël me një bosht që drejtohet në këmbë nga operatori duke përdorur bigën (timonin). Organet punues janë të përbërë nga një shat rrotullues.

Aksidentet e shkaktuara nga motoplugu gjithmonë shkaktojnë dëmtime shumë të rënda dhe, në veçanti amputimin (gjymtimin) e gjymtyrëve të poshtme. Kjo është arsyeja për të cilën operatori që drejton makinën duhet gjithmonë të mbrohet nga çdo kontakt me të.

Përdorni vetëm motoplug të pajisur me karter mbrojtës të frezës (MOS E HIQNI KURRË!) dhe me mekanizëm automatik të ndalimit në momentin e braktisjes së timonit dhe verifikoni që mjeti të jetë i pajisur me një mekanizëm që ndalon funksionimin e frezës kur futet marshi për ecjen prapa.



Motoplugu duhet të përdoret vetëm nga persona të përgjegjshëm, të udhëzuar paraprakisht në lidhje me përdorimin e tij dhe të autorizuar për të punuar me makinën. Ndalohet përdorimi i makinës nga fëmijët me moshë më të vogël se 16 vjeç.

Kombajna e sanës

Gjatë përdorimit të kësaj makine bujqësore është e nevojshme të mbrohem kundër kontakteve aksidentale me organet punuese. Kur makina është në pozicion pune, veglat duhet të jenë të mbrojtura si në zonën ballore, në drejtim të avancimit të makinës ashtu edhe në të dyja pjesët anësore.

Një mekanizëm mbrojtës i përshtatshëm është zbarra distancuese që duhet të sigurojë një distancë horizontale të sigurisë minimale me të paktën 150 mm nga pjesët e lëvizshme.

Në fund të punës, makina duhet të jenë e shkëputur nga traktori (sipas udhëzimeve të konstruktorit në manualin e përdorimit dhe të mirëmbajtjes) dhe e vënë në pozicion sigurie me rotativët e jashtëm të ngritur. Rotativët mund të orientohen drejt brendësisë së makinës me anë të kapërdimjes së tyre; të mbrojtur anash nëpërmjet një zbarre distancuese; të mbrojtur nga barriera të vendosura rrafsh, me majat më të jashtme anash.

KUJDES!

Verifikoni që dalja e gazrave të shkarkimit të jetë e pozicionuar në mënyrë që të drejtojë emisionet e gazta larg nga operatori në vendin e punës dhe që marmita të jetë e pajisur me karter mbrojtës të termo-izoluar.



KRASITJA DHE VJELJA E FRUTAVE

Një nga instrumentet e përdorura për krasitje është videri (kultivator tëharrës), vegël me motor që në sajë të rregullimit të fuqisë së tij dhe aksesorëve të ndryshëm, mund të përdoret për të prerë barin, për të pastruar pjesën poshtë pemëve në pyll, për eliminimin e shkurreve e për të prerë drurët e hollë dhe të rinj. Është e rëndësishme që të kemi parasysh se me përdorimin e viderit, janë të lidhur rreziqe të mundshme të shumta, duke filluar nga aksidentet e prerjeve deri tek djegiet dhe/apo lëndimet nga kontakti me mbeturinat dhe/ose materialet e hedhura.

Krasitja

- Përdorni gjithmonë mjete të përshtatshme mbrojtëse individuale për sytë, kokën dhe këmbët;
- verifikoni që marmita të jetë e pajisur me karter mbrojtës të termozoluar dhe që makina të jetë e pajisur me mekanizmin e ndalimit automatik;
- orientoni tubin e emetimit të gazeve të shkarkimit në mënyrë që të mos drejtojë emisionin në drejtim të operatorit;
- gjithmonë kontrolloni gjendjen e përsosur të serbatorit për të



Janë të detyrueshme, për përdorimin e viderit (kultivatorit tëharrës), PMI e parashikuara nga konstruktori, sidomos për sytë. Duhet gjithashtu edhe një veshje e përshtatshme dhe përdorimi i çizmeve të gomës.

parandaluar rrjedhjet e karburantit gjatë përdorimit të mjetit.

Vjelja e frutave

Gjatë operacioneve të vjeljes së frutave përdoret zakonisht një shkallë mbështetje:

- kontrolloni gjithmonë shkallët para se t'i përdorni;
- përdorni gjithmonë këpucë kundra rrëshqitjes;
- mbështetni shkallën në mënyrë të qëndrueshme në degë dhe nëse është e mundur kërkonin ndihmën e një operatori ta mbajë atë nga poshtë;
- shmangni punimet në pozicione ekuilibri të paqëndrueshëm.

KUJDES!

Të gjitha makinat me një peshë pa ngarkesë më të madhe se 7.5 kg dhe të gjithë viderat me teher në formë sharre, duhet të jenë të pajisur me një sistem rripash në të dyja shpatullat. Sistemi lidhës i rripave në të dy shpatullat duhet të jetë i pajisur me një mekanizëm çlirues të shpejtë dhe duhet të jetë i pajisur me një mbushje në nivelin e ijëve.



RREZIKU ELEKTRIK NË NDËRMARRJEN BUJQËSORE

Përdorimi i energjisë elektrike mund të shfaqë rrezik për njerëzit, kafshët dhe sendet. Në ndërmarrjen bujqësore kushtet e veçanta të ambientit mund të rrisin rreziqet, pra ekspozimin ndaj rrezikshmërisë.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet impianteve elektrike të ndërtesave që shërbejnë për rritjen e kafshëve (stallat me salla mjelje, tharqet e derrave, vathët e deleve etj.) dhe ndërtesave të përdorura për magazinimin e foragjereve dhe ushqimit për kafshët, në të cilat janë më të larta rreziqet e zjarrit dhe/ose të shpërthimit dhe shkarkimeve elektrike për shkak të pranisë së lëngjeve dhe fluideve,



madje edhe nën presion, të cilat mund të kenë efekte kimikisht agresive (dezinfektues, acide, jashtëqitjet e kafshëve...).

Përveç kësaj:

- Verifikoni që kabllot elektrike të mos ndërhyjnë me kalimin ose ndalimin e kafshëve;
- përdorni zgjatje (prolunga) me kablo të tipit fleksibel, prej gome neoprenike;
- parandaloni akumulimin e pluhurave të djegshëm në afërsi të kuadrove elektrik;
- parandaloni gjithmonë metodën "e bëj vetë" për pjesët elektrike nën tension.

Veprat e riparimit dhe/ose të mirëmbajtjes duhet të kryhen gjithmonë nga një personel i specializuar dhe i kualifikuar.



Impianti elektrik duhet të pajiset me mekanizëm "tokëzimi" dhe mekanizëm "salvavita" (shpëtues-jete).

KUJDES!

STALLAT

Stalla, ambient i caktuar për strehimin e kafshëve shtëpiake, veçanërisht për bagëtitë e trasha dhe të imëta është zakonisht një lokal me dysheme të rrëshqitshme: rrezikshmëria konstante pra është rrëshqitja me pasojë lëndimet.

Dyshemetë duhen pajisur në sipërfaqe me nervëzim; duhen përdorur këpucë kundra rrëshqitjes; dhe duhen mbajtur pastër dyshemetë.



PUNËT SHTËPIAKE



Secili prej nesh e shoqëron më kollaj rrezikun e aksidentit me një aktivitet pune specifik ose me detyrimin që ka për të lëvizur me një mjet transporti. Në shumicën e rasteve, ambienti shtëpiak duket si një vend i sigurt. Në fakt edhe shtëpia “fsheh” rreze dhe aksidente shtëpiake që mund të kenë pasoja madje të rënda për shëndetin. Incidenca e rrezikut, në fakt, është e lidhur drejtpërdrejt me kohën e kaluar ndërmjet mureve të shtëpisë dhe me llojin e aktivitetit që kryhet.

Sipas një studimi të kryer nga Censis në vitin 2009, ka dalë në pah se 44.3% e punëtorëve shtëpiak deklaroi se ka pasur të paktën një aksident në punë vitin e kaluar; nga këto, 11.2% ka pasur më shumë se një rast aksidenti. Duke iu referuar trevjeçarit të fundit përqindja rritet në 61.2%, ndërsa duke marrë parasysh krejtësisht gamën e jetës profesionale, përqindja arrin në 70.5%.

Rasti më i zakonshëm ndodh nga veprimet jo vetëm të gabuara, por me “rrezik”. Nëse rastësia, lodhja ose dobësia fizike mbeten një faktor i rëndësishëm për sa i përket kazistikës (rasteve), veprimet e kryera çdo ditë dhe që konsiderohen të padëmshme shpesh çojnë në nënvlerësimin e të gjitha burimeve të rrezikut të pranishme në shtëpi.

Është e nevojshme, për këtë arsye, një vëmendje të vazhdueshme për sjelljen që duhet të mbajmë në situata të ndryshme.

RRËZIMET DHE PËRPLASJET

Karakteristikat strukturore të banesës (shkallët, dyshemetë, mobilet, etj.) mund të jenë shkaku i rrëzimeve dhe i përplasjeve. Për më tepër, punëtori në një ambient që mbetet në thelb i huaj (pjesa më madhe e punëtorëve shtëpiakë punojnë për pak orë dhe në ambiente vazhdimisht të ndryshme dhe ndoshta duke bërë punë të ndryshme), tenton të zvogëlojë qetësinë dhe vëmendjen, të cilët janë elementët e nevojshëm për sigurinë e punëtorit.

Për t'u mbrojtur nga rrëzimet:

- përdorni mbështetje të qëndrueshme për aktivitetet në të cilat është e nevojshme që të arrihen lartësi të mëdha (pastrim dritarësh, rregullime raftesh, etj.);
- evitoni lënie e karrigeve ose të mobilieve pranë dritareve sepse fëmijët mund t'i përdorin t'u kacavarur;
- evitoni lyerjen me shumë dyllë të dyshemesë dhe parashikoni përdorimin e një lloj dylli kundra rrëshqitjes;
- duhet të keni kujdes që të mos rrëshqisni mbi shtrojat dhe qilimat e shtëpisë, sidomos nëse ata nuk janë të pajisur me një rrjetë kundra rrëshqitjes.



Një vëmendje konstante jep mundësinë që të mos nënvlerësohen burimet e rrezikut të pranishme në shtëpi, madje edhe kur kryhen veprime që konsiderohen si të padëmshme.

Për t'u mbrojtur nga përplasjet:

- keni kujdes që të mos lini gjëra të shpërndara mbi tokë;
- kushtoni vëmendje lëvizjeve kur punohet në afërsi të deryve me xhama, të kolonave të izoluara ose të qosheve të murit;
- mbyllni sirtarët e mobilieve pasi të keni marrë objektet e nevojshme.

KUJDES!

Megjithëse incidenti më i shpeshtë është ai kur biem ose rrëshqasim, shumë pak bashkëpunëtorë deklarojnë se kanë marrë masa në këtë drejtim (vetëm 25.8% përdorin këpucë kundra rrëshqitjes dhe vetëm 34.1% sigurohet që dikush është i pranishëm në shtëpi kur hip në shkallë ose kur kryen punë me rrezikshmëri); në qoftë se hutimi përbën faktorin kryesor të rrezikut, vetëm një pakicë (32.1%) evitojnë që të bëjnë disa punë në qoftë se ndjehen shumë të lodhur (Studimi Censis 2009).



DIEGIE DHE PRERJE

Disa sjellje, të tilla si përdorimi i pavend i aparaturave dhe veglave, mund të shkaktojë djegie dhe prerje. Mjafton të mendojmë se aktivitetet e lidhura me kuzhinën janë shkaku i dytë i incidenteve shtëpiake dhe se përdorimi i thikave shkakton përqindjen më të lartë të plagosjeve ndërmjet incidenteve të këtij lloji.

Për t'u mbrojtur kundër djegieve:

- vendosni enët mbi furnela me dorezë me drejtim nga brenda;
- duhet t'i vini vëmendje të veçantë furrës në qoftë se ajo është e vendosur në nivelin dyshemesë, kur është në funksionim dhe, sidomos, kur dera e saj është e hapur;
- mbani qetësinë dhe mbuloni me një kapak të gjithë tiganin në qoftë se vaji merr flakë. Mos provoni kurrë të shuani zjarrin e vajit me ujë, sepse mund të digjeni dhe mund të përhapni zjarrin në ambientin përreth;
- periodikisht verifikoni funksionimin e duhur të valvulës së sigurisë së tenxheres (kusicës) me presion; është një praktikë e mirë pune që të respektojmë sinjalin e sasisë maksimale që jepet dhe të mos e përdorim me një zjarr shumë të fortë, sepse tenxherja me presion mund të shpërthejë, duke ngritur me forcë kapakun dhe duke nxjerrë përjashta lëngun e nxehtë.

Për t'u mbrojtur nga prerjet:

- duhet të sigurohuni që doreza e thikës të jetë e thatë dhe e pastër përpara se ta përdorni atë, kështu që nuk do të rrëshqasë nga dora. Pas përdorimit, thika nuk duhet lënë pranë sipërfaqes

(banakut) së punës ose mbi sipërfaqe të tjera nga të cilat ajo mund të bjerë. Gjatë përdorimit, maja e thikës duhet të jetë e drejtuar nga ana e jashtme e asnjëherë ndaj trupit ose ndaj krahëve dhe duarve;

- duhet të keni kujdes kur thikat lahen me dorë: uji me sapun, mund t'i fshehë dhe kështu, duke mos i parë favorizohen prerjet për shkak të përplasjeve aksidentale. Vendosni thikat me teh poshtë në trungun përkatës ose në hapësirën e tyre në sirtar;
- përdorni me vëmendje të gjitha pajisjet e vogla elektroshtëpiake me thika (gërshërë, rrahëse, hapëse kutish, etj.).

KUJDES!

Mos fusni asnjëherë duart brenda rrahëseve, grirëseve të mishit, robotëve të kuzhinës ose makinave prerëse, pa i shkyçur më përpara nga rrjeti elektrik dhe të keni prituri që pjesët prerëse të kenë pushuar së lëvizuri. Në rast dyshimi lidhur me përdorimin korrekt të pajisjes elektroshtëpiake, gjithmonë referohuni manualit të tij të udhëzimeve.



Asnjëherë mos përdorni ujë për të shuar vajin e ndezur, sepse do të arrihet efekti i kundërt, duke rrezikuar djegien dhe përhapjen e zjarrit në objektet përreth.



RREZIKU ELEKTRIK

Trupi i njeriut është një përçues i mirë që lejon të përshkohet lehtësisht nga rryma elektrike. Kur trupi i njeriut bie në kontakt me çfarëdo elementi nën tension, ai përshkohet nga rryma elektrike e cila shkarkohet në tokë duke kaluar nëpërmjet këmbëve. Kur ka lagështi rezistenca që paraqitet nga trupi i njeriut bëhet më e ulët dhe në këtë mënyrë rrit rrezikun e goditjes elektrike.

- Kur përdoret hekuri për hekurosje duhet të keni kujdes që të mos mbushni kaldajën e tipit me avull me spinën e futur dhe aparatën nën tension, edhe pse çelësi është i fiksuar, sepse uji mund të lagë një teljo të izoluar ose të dëmtuar, duke shkaktuar një rrjedhje të rrymës elektrike. Asnjëherë nuk duhet të hekurosni me këmbët



e zhveshura ose me duar të lagura, pasi në rast të përkeqësimit të pjesëve të izolimit (p.sh. të kordonit të hekurit për hekurosje), duart e lagura dhe këmbët e zhveshura do të lehtësonin kalimin e rrymës elektrike nëpërmjet e trupit;

- vishni këpucë mundësisht me shtroje izoluese (gome) dhe duart duhet të jenë të thata kur përdoret tharësja e flokëve ose pajisjet e tjera të vogla elektroshtëpiake;
- periodikisht kontrolloni kabllon e ushqimit me rrymë elektrike të pajisjeve elektroshtëpiake (hekuri për hekurosje, fshesa me korrent, lustruesja e dysHEMEVE, etj.) duhet të jenë në gjendje të mirë. Përveç kësaj, pas përdorimit, aparati duhet fiksuar dhe spina duhet të shkëputet duke evituar që të tërhiqet kordoni i ushqimit;
- komponentët elektrike nën tension nuk duhen lënë brenda hapësirave ku mund të arrihen nga fëmijët;
- këni kujdes që kabllot elektrike nën tension të mos prekin tokën mbi dysHEMETË

me lagështi ose të lagura;

- vendosni llambat e ndriçimit dhe aparataturat elektrike larg nga çdo pikë që është burim uji. Nuk duhet, megjithatë, të përdorim pajisje elektrike të ndryshme (piastra, makina roje, tharës flokësh, rrahëse, etj.) në afësi të ujit.

KUJDES!

Sinjalizoni te punëdhënësi çdo problem në lidhje me impiantin elektrik. Të gjithë impiantet elektrike, përveç instalimeve që duhen bërë nga firma të autorizuar që certifikojnë impiantin “shkëlqyeshëm” me deklaratën e konformitetit, duhet të mbahen në efikasitet nga ndërmarrje të kualifikuara. Edhe një defekt i thjeshtë duhet t’i besohet gjithmonë personelit të kualifikuar.

24.7% e punonjësve deklarojnë se përdorin rregullisht pajisjet elektrike shtëpiake me duar ose këmbë të lagura, 44.4% bën riparime të vogla pa u kujdesur për të shkëputur rrymën elektrike; 38.3% përdor pajisje të reja shtëpiake pa lexuar udhëzimet, 10% i fik aparatet elektrike duke tërhequr kordonin e ushqimit me rrymë elektrike dhe 7.6% harron hekurin ndezur (Studimi Censis 2009).

LËNDËT E RREZIKSHME

Produktet kimike që fusim çdo ditë në shtëpitë tona (produkte për pastrime, ilaçe, etj.) kërkojnë kujdes dhe vëmendje në mënyrën se si i përdorim dhe se si i ruajmë. Etiketa dhe skeda e të dhënave të sigurisë që gjejmë mbi kontejnerët na ndihmon për të njohur substancat e përdorura dhe, nëpërmjet simbologjisë përkatëse, rrezikshmërinë që mund të vërtetohet për shkak të përdorimit të tyre. Prandaj është e mirë:

- që produktet nuk duhen lënë dokudo ose të paruajtur dhe duhet t'i vendosim gjithmonë në vendet e duhura që shërbejnë për ruajtjen e tyre, e kryesisht në qoftë se në shtëpi ka fëmijë;
- të ndjekim udhëzimet e dhëna nga prodhuesi me përpikëri për sa i përket dozave dhe modaliteteve të përdorimit dhe duhet shmangur përzjerja e produkteve të ndryshme, në mënyrë që të mos shkaktojmë reagime të padëshiruara kimike me rrezikshmëri për organizmin;



Kushtoni vëmendje të veçantë eliminimit të produkteve kimike dhe mos i hidhni tek plehrat e zakonshme. Për barnat, kontrolloni gjithmonë datat e skadimit të ilaçeve dhe, nëse u ka kaluar afati, hidhni ato në enët përkatëse që gjenden për shembull në farmacitë e ndryshme.

- të keni kujdes që të ruani produktet e ngjashme së bashku (për shembull: lëndët e ndezshme me të ndezshmet) në mënyrë që të zvogëloni gabimet e mundshme gjatë marrjes së tyre dhe përdorimit të mëvonshëm. Përveç kësaj, është e nevojshme që t'i ruani ato në ambalazhin e tyre origjinal, pa i hedhur substancat në kontejnerët e tjerë;
- edhe barnat i përkasin kategorisë të substancave me rrezikshmëri dhe duhet të trajtohen me të njëjtin kujdes.

KUJDES!

Etiketa dhe skeda e të dhënave të sigurisë që gjendet mbi kontejnerët na ndihmon të njohim substancat e përdorura dhe rrezikshmërinë e lidhur me keqpërdorimin e tyre. Mbi çdo etiketë ose direkt mbi ambalazh, tregohen në fakt, nëpërmjet simboleve të veçanta, rreziqet specifike të produktit të përdorur, për shembull, nëse është korroziv, ose toksik apo i ndezshëm, etj.



GAZE TË NDEZSHËM

Gazet e djegshme për përdorim shtëpiak janë metani dhe GPL. Këto gaze kanë një rrezikshmëri potenciale dhe kjo varet kryesisht nga mënyra se si i përdorim ato.

Për të ndezur furnelat me shkrepëse përdorni sekuencën e saktë të veprimeve:

- ndizni shkrepësen, afroni shkrepësen e ndezur pranë ndezësit, hapni rubinetin e gazit;
- në mungesë të sistemeve moderne të sigurisë që bllokojnë furnizimin me gaz në rast të fikjes së flakës, kontrolloni gjithmonë, gjatë përdorimit të piashtës së gatimit, që kjo të mos fiket;
- kontrolloni periodikisht që tubi i gomës që lidh bombolën e gazit GPL të jetë larg nga burimet e ngrohjes, të mos formojë kthesa shumë të ngushta ose ngushtime dhe të jetë i shtrënguar mirë në skaje. Kontrolloni periodikisht tubin metalik që lidh metanin me përdoruesin, për shkak se ai tenton që të thyhet me kalimin e kohës. Sidoqoftë këto tuba duhet të zëvendësohen të paktën çdo 4 vjet nga instaluesit e specializuar dhe mbi tubat me markën IMQ-UNI CIG jepet viti limit i përdorimit të tyre ("duhet zëvendësuar brenda datës ...").

Metani është pa erë, pa ngjyrë dhe pa shije. Para se të shpërndalet në rrjetin e shtëpive, më pas, vihet në kontakt me një përbërje kimike që i jep "aromën e gazit" karakteristike, në mënyrë që të bëhet e ndjeshme prania e tij në ambient dhe për të pakësuar rrezikshmërinë.

Në qoftë se ndjeni erë gazi:

- është e rëndësishme të mos ndizni absolutisht asnjë lloj flake dhe të mos vini në veprim asnjë gjë që mund të shkaktojë shkëndija (çelësa elektrike, zile, telefona, etj.);
- menjëherë hapni dyert dhe dritaret për të ajrosur dhomën ku është ndjerë prania e gazit;
- mbyllni, nëse është e mundur, rubinetin e gazit, të kontaktorit ose të bombolës;

- kthehuni në shtëpi ose në vendin ku është vërtetuar humbja e gazit, vetëm kur nuk ka më erë gazi.

KUJDES!

Sinjalizoni punëdhënësit çdo problem që është zbuluar në impiantin e gazit. Për realizimet e reja apo rinovimet e impianteve dhe për çdo ndërhyrje në impiantet dhe aparaturat e ushqyera nga gaze të ndezshëm është e nevojshme t'i drejtoheni instaluesve të specializuar.



RREZIKU KIMIK



Në sektorin e Kimisë, sipas klasifikimit ISTAT (Instituti kombëtar i statistikës në Itali), përfshihet një gamë e gjerë produktesh: ilaçesh, elementë për prodhimin e fibrave sintetike, detergjente, eksploziv, vernik, etj.

Angazhimi i fortë në kërkimet shkencore dhe në inovacionin reflektohet në rënien e numrit të denoncimeve për aksidente që, tashmë për disa vjet, po regjistrohen në këtë sektor.

Rreziku mund të rezultojë nga ekspozimi ndaj substancave kimike në gjendje të ngurtë, të lëngshme, të gaztë ose aerosol. Këto mund të shkaktojnë efekte të dëmshme mbi organizmin e njeriut kur thithen, gëlltiten ose absorbohen me anë të kontaktit. Disa dëme janë menjëherë të dukshme, të tjerët mund të manifestohen edhe pas shumë viteve.

AKSIDENTET NË AMBIENTE TË KUFIZUARA

Me hapësirë të kufizuar kuptojmë një hapësirë të mbyllur, të karakterizuar nga hapje të kufizuara për hyrje me një ventilim natyror të pafavorshëm. Bëhet fjalë pra për silos, vende magazinimi, kanalizime apo gropa septike, dhoma ose kontejnerë me hapje nga lart, vaska (tanke) apo depuratorë (kullues), ku mund të verifikohet një ngjarje aksidentale e rëndë për shkak të agjentëve kimikë me rrezikshmëri.

Rreziqet që lidhen me këtë lloj ambient pune kryesisht janë:

- **asfiksia:** nga qëndrimi për një kohë të gjatë në vende me këmbim të varfër ajri ose nga reaksionet kimike që çojnë në konsumimin e oksigjenit;
- **helmimi:** nga inhalacioni ose nëpërmjet kontaktit me anë të lëkurës të substancave toksike;
- **zjarri ose shpërthimi:** nga prania e agjentëve kimikë të aftë për të shkaktuar një reaksion shpërthyes.

Duhet që, para se të ndërmerret çdo veprim, të vlerësohen të gjitha masat e nevojshme që japin mundësi për të vepruar pa hyrë në hapësirat e mbyllura. Nëse është e nevojshme që të hyjmë, duhen

Përdorimi i PMI të parashikuara dhe respektimi i normave procedurale ndihmon për të parandaluar faktorët e mundshëm të rrezikut që lidhen me praninë e substancave të dëmshme në ambiente të mbyllura dhe të ajrosura keq.

përdorur të gjitha PMK (pajisjet e mbrojtjes kolektive) për të kryer punën në mënyrë të sigurt.

Gjatë punimeve në hapësirat e mbyllura është me rëndësi vendimtare që të veshim PMI (maska, doreza, syze, tuta, këpucë, etj.) të duhura dhe specifike; për shembull, për t'u mbrojtur nga gazet ngacmues nuk është e mjaftueshme që të veshin një maskë dosido, por duhet të përdorim maskën specifike kundra atij lloj agjenti.

Kush punon në ambiente pune të mbyllura duhet të mësohet me përdorimin e PMI, për procedurat e urgjencës dhe të ndihmës së shpejtë për të shpëtuar kolegët.



KUJDES!

Duhet të theksohet se, në mënyrë që të mbrohet shëndeti i punëtorëve që punojnë në këto ambiente, jemi të detyruar sipas ligjit që të identifikojmë vlerat kufi të ekspozimit ndaj substancave kimike. Për një vlerësim korrekt të kushteve higjienike-ambientale, është gjithashtu praktikë e zakonshme që t'i referohemi vlerave limit të pragut (Threshold Limit Values - TLV), megjithëse këto janë vetëm përqendrimet maksimale të pranueshme dhe për këtë arsye duhet të konsiderohen vetëm si rekomandime.





PAJISJET E MBROJTJES INDIVIDUALE DHE SISTEMI I SHENJAVE TË SIGURISË

Sistemi i shenjave të sigurisë jep një informacion ose një dispozitë në lidhje me sigurinë në vendin e punës dhe mund të përdorë një tabelë, një ngjyrë, një sinjal me dritë ose akustik, një komunikim verbal ose një sinjalizim gjestual. I gjithë sistemi i shenjave të sigurisë duhet të jetë konform me D.Lgs. 81/08.

PAJISJET E MBROJTJES INDIVIDUALE (PMI)

Dekreti Legjislativ 81/08 përcakton si pajisje mbrojtëse individuale (PMI) «të gjitha pajisjet e projektuara për t'u veshur dhe mbajtur nga punonjësi me qëllim që ta mbrojnë atë kundra një ose më shumë rreziqesh, që mund të kërcënojnë sigurinë dhe shëndetin e tij gjatë punës, madje edhe çdo pjesë shtesë ose aksesor të projektuar për këtë qëllim».

Në bazë të rrezikut kemi PMI për: mbrojtjen e kokës; mbrojtjen e rugëve të frymëmarrjes; mbrojtjen e syve; mbrojtjen e dëgjimit; mbrojtjen e gjymtyrëve të sipërme dhe gjymtyrëve të poshtme; mbrojtjen e trupit, parandalimin e rrëzimeve.

Në varësi të veprimtarisë së kryer nga subjektet e ndryshme, PMI ndahen në:

- PMI të kategorisë së parë: janë të projektuara thjeshtë dhe ndihmojnë për të mbrojtur punonjësën nga rreziku i dëmeve fizike të lehta. Për shembull, janë PMI të kategorisë së parë ato që mbrojnë punonjësën nga fenomene të zakonshme atmosferike gjatë veprimtarisë profesionale apo nga veprimi dëmtues i rezeve të diellit;
- PMI të kategorisë së dytë: janë pajisjet që mbrojnë nga një rrezik i rëndësishëm, të projektuar veçanërisht për mbrojtjen e syve, krahëve, duarve dhe fytyrës. Duhet të certifikohen nga një organ kontrolli i autorizuar;
- PMI të kategorisë së tretë: janë ato të projektuara në mënyrë të ndërlikuar dhe mbrojnë punëtorin nga rreziqet e vdekjes ose

Duke pasur parasysh frekuencën e lartë të përdorimit dhe për të shmangur lindjen e problemeve për punonjësën, është mirë që punëdhënësi të marrë masa për të zëvendësuar PMI porsa që ata tregojnë shenjat e parë të konsumimit.

nga plagosjet e rënda dhe të përhershme. Në këtë kategori përfshihen, për shembull, PMI që mbrojnë nga rrëzimi nga lartësia, ose që mund të përdoren si izolues për tensionet e larta elektrike. Për të përdorur PMI që bëjnë pjesë në këtë kategori duhen ndjekur kurset mësimore të përdorimit.

Për t'u futur në treg PMI duhet të plotësojnë disa kërkesa specifike të sigurisë, në mënyrë që të kenë një "deklaratë konformiteti", pa të cilën nuk mundën as të shiten e as të përdoren.

KUJDES!

Çdo PMI duhet të ketë manualin e vet të përdorimit dhe të mirëmbajtjes që përshkruan përdorimin e saj të duhur, në varësi të llojit të rrezikut për të cilin përdoret, dhe procedurat e mirëmbajtjes që duhet të kryhen për të ruajtur një shkallë të lartë të mbrojtjes dhe të vlefshmërinë. Është e rëndësishme që punonjësi të ruajnë me korrektësi PMI dhe t'i sinjalizojë referentit të tij çdo defekt ose të metë që spikat në një pajisje të veçantë.



FORMAT, NGJYRA DHE KUPTIMI I SINJALEVE

Sinjalet paralajmëruese dallohen nga ngjyra, skica, forma dhe madhësia. Secilit prej tyre i caktohet një klasë e veçantë e paralajmërimeve dhe distanca nga vendi i sinjalizimit në të cilin duhet të vendosen, në përputhje me aneksin 1 të D.Lgs 493/96. Më poshtë janë renditur disa prej sinjaleve më të përdorura në vendet e punës por jo vetëm aty.



Tabelat ndaluese: kanë formë të rrumbullakët, piktoqram të zi në sfond të bardhë; shirit të kuq në drejtim poshtë nga e majta në të djathtë përgjatë simbolit me një pjerrësi prej 45 °, të kuqe (e kuqja duhet të mbulojë së paku 35% të tabelës)



Tabelat përshkruese: kanë formë të rrumbullakët, piktoqram të bardhë në një sfond kaltër (ngjyra e kaltër duhet të mbulojë së paku 50% të sipërfaqes së tabelës)



Tabelat paralajmëruese: kanë formë trekëndëshi; piktoqram të zi në një sfond të verdhë (e verdha duhet të mbulojë së paku 50% të sipërfaqes së tabelës)



Tabelat e shpëtimit: kanë formë katrore ose drejtkëndëshi; piktoqram të bardhë në një sfond jeshil (jeshilja duhet të mbulojë së paku 50% të sipërfaqes së tabelës)



Tabelat kundërzjarrit: kanë formë katrore ose drejtkëndëshi; piktoqram të bardhë në një sfond të kuq (e kuqja duhet të mbulojë së paku 50% të sipërfaqes së tabelës)

TABELAT NDALUESE



Ndalohet duhani



Ndalohet përdorimi i flakës së lirë



Ujë jo i pijshëm



Ndalohet hyrja për karrelat e zhvendosjes



Ndalohet hyrja për këmbësorët



Ndalohet të shuajmë me ujë



Mos prek



Ndalohet hyrja e personave të paautorizuar

TABELAT E PËRSHKRIMIT



Mbrojtje e detyrueshme e syve



Helmeta mbrojtëse e detyrueshme



Mbrojtje e detyrueshme e dëgjimit



Mbrojtje e detyrueshme e rrugëve të frymëmarrjes



Mbrojtje individuale e detyrueshme kundra rrëzimeve



Këpucët e sigurisë të detyrueshme



Dorëzat e sigurisë të detyrueshme



Mbrojtje e detyrueshme për trupin



Mbrojtje e detyrueshme për fytyrën



Kalim i detyrueshëm për këmbësorët

TABELAT PARALAJMËRUESE



Material i ndezshëm



Material eksploziv



Substanca helmuese



Substanca gërryese



Temperaturë e ulët



Ngarkesa të pezulluara



Karrela për zhvendosje



Tension elektrik i rrezikshëm



Rrezik i përgjithshëm



Substanca të dëmshme ose ngacmuese



Materiale radioaktive



Rreze laser



Material djegës



Rrezatime jo-jonizuese



Rrezik biologjik



Fushë magnetike intensive



Rrezik rrëshqitje



Rënie nga disniveli

TABELAT E SHPËTIMIT



Drejtimit për t'u ndjekur - Rrugëtim - Dalje emergjence



Ndihmë e Shpejtë



Telefon për shpëtim dhe ndihmën e shpejtë



Barelë



Dush sigurie



Lavazhi i syve

TABELAT KUNDËRZJARRIT



Telefon për ndërhyrje kundërzjarrit



Shigjetë kundërzjarrit



Shkallë



Fikës



Drejtimit për t'u ndjekur

AKSIDENTI DHE SËMUNDJA PROFESIONALE: ÇFARË DUHET BËRË?

Çfarë duhet të bëjë punonjësi në rast fatkeqësie në punë:

- të informohet menjëherë punëdhënësi;
- në rast të sëmundjes profesionale: duhet të informohet punëdhënësi brenda 15 ditëve.

Çfarë duhet të bëjë punëdhënësi:

- pasi të jeni informuar për ngjarjen, dërgoni në INAIL (Instituti kombëtar për sigurimin kundër aksidenteve në punë), brenda 2 ditëve në rast aksidenti, dhe 5 në rastin e sëmundjes profesionale, denoncimin e aksidentit ose të sëmundjes profesionale, duke plotësuar formularët përkatës që jepen nga INAIL;
- nëse bëhet fjalë për aksident vdekjeprurës ose për të cilin ekziston rreziku i vdekjes, denoncimi duhet të bëhet me telegram brenda 24 orëve pas ngjarjes.

Sigurimi INAIL është i rregulluar nga normat që përmbahen në Tekstin Unik (Testo Unico) të dispozitave mbi sigurimin e detyrueshëm kundër aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale

(T.U. n. 1124/65), në Dekretin legjislativ n. 38/2000 dhe dispozitat speciale (punëtorët shtëpiakë, gratë shtëpiake, mjekët radiolog, etj.).

Në Tekstin Unik dhe në Dekretin Legjislativ n. 38/2000 janë përcaktuar subjektet që duhet të sigurohen dhe aksidentet e sëmundjet për të cilat njihet shkaku për arsye pune.

INAIL mbron edhe punëtorët që aksidentohen gjatë udhëtimit vajtje ardhje nga vendet e punës (aksident gjatë rrugës për në punë).

Janë të siguruar ndaj aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale (për çfarëdo sektor pune në të cilin ata veprojnë) të gjithë ata që janë të punësuar nga persona fizikë ose juridikë, subjekte private ose ente publike.

Shëndeti dhe siguria në punë janë një e drejtë themelore: punëdhënësit dhe punonjësit kanë përgjegjësi të përbashkët, për shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.



AGJENT KIMIK Çdo element ose kombinim kimik, vetëm ose në përzierje me të tjerët, i pranishëm në natyrë ose i përftuar artificialisht.

AKSIDENT SHTËPIAK Sipas përcaktimit të dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikës, në studimet me shumë qëllime, aksidenti i llojit shtëpiak është një incident që paraqet disa karakteristika që sjellin dëmtimin e përkohshëm ose të përhershëm të kushteve shëndetësore të një personi, për shkak të lëndimeve të llojeve të ndryshme, verifikohet pavarësisht nga vullneti njerëzor, verifikohet në një banesë, e kuptuar si bashkim i vetë apartamentit dhe çdo zgjerimi tjetër të mundshëm të jashtëm (ballkone, kopsht, garazh, bodrum, shkallë etj.)

DËM Çdo ndryshim, i përkohshëm ose i përhershëm, i organizmit të njeriut, i pjesëve të tij ose i funksioneve.

KOMUNIKIM VERBAL DHE GJESTUAL Komunikimi verbal është çdo mesazh që jepet duke përdorur zërin e njeriut. Sinjalizimi gjestual është tërësia e lëvizjeve të krahëve dhe duarve, sipas formave konvencionale, për të drejtuar punëtorët që bëjnë manovra të rrezikshme ose me rrezikshmëri.

MJEK KOMPETENT Është një mjek i specializuar në mjekësinë e punës që bashkëpunon me punëdhënësin dhe me shërbimin e parandalimit dhe të mbrojtjes për një organizim korrekt të ndërmarrjes.

PAJISJE PËR MBROJTJEN INDIVIDUALE (PMI) Çdo pajisje e menduar për t'u veshur dhe mbajtur nga punonjësi me qëllim që ta mbrojë kundra një ose më shumë rreziqesh, që mund t'i kërcënojnë sigurinë dhe shëndetin gjatë punës.

PARANDALIM Kompleksi i dispozitave ose i dispozitave të nevojshme për të parandaluar apo zvogëluar rreziqet profesionale në lidhje me respektimin e shëndetit të popullatës dhe të integritetit të ambientit të jashtëm

PËRFAQËSUES I PUNËTORËVE PËR SIGURINË (PPS) Është një punonjës i ndërmarrjes, i zgjedhur ose i caktuar për të përfaqësuar punëtorët në të gjitha çështjet në lidhje me shëndetin dhe sigurinë gjatë punës.

PUNËDHËNËS Është subjekti titullar i raportit të punës me punëtorin. Në përgjithësi, identifikohet si ai që ka përgjegjësinë e organizimit në të cilin punonjësi jep punën e tij ose si ai që mban fuqinë e vendim-marrjes dhe të shpenzimeve të vetë organizimit të ndërmarrjes.

PUNONJËS Person që, pavarësisht nga tipologjia e kontratës, kryen një aktivitet pune, me një punëdhënësin publik ose privat, me ose pa pagesë, madje edhe vetëm për të mësuar një zana, një art ose një profesion.

RREZIK Është probabiliteti për të arritur nivelin e dëmit të mundshëm, në kushtet e

përdorimit apo të ekspozimit ndaj një faktori të veçantë ose agjenti apo ndaj kombinimit të tyre.

RREZIKSHMËRI Është veçoria e një faktori të caktuar ose e një agjenti për të shkaktuar dëme.

SINJAL AKUSTIK DHE ME DRITË Sinjali akustik është një sinjal me zë i emetuar nga pajisja përkatëse, pa përdorimin e zërit njerëzor. Sinjali me dritë është ai që emetohet nga një pajisje me material transparent të ndriçuar nga brenda apo nga mbrapa, në mënyrë që të duket ai vetë si i ndritshëm.

SHËRBIMI I PARANDALIMIT DHE I MBROJTJES (SHPM) Është një grup njerëzish, sistemesh dhe mjeteve të jashtme ose të brendshme të ndërmarrjes që synojnë parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet profesionale brenda ndërmarrjes.

TABELË Sinjal me formë të ndryshme gjeometrike, ngjyrë ose simbol që jep një udhëzim të saktë ku dukshmëria e tij është e garantuar në mënyrë të mjaftueshme.

VEND PUNE Çdo vend i destinuar për veprimtari pune, i vendosur brenda ndërmarrjes ose njësisë prodhuese, apo çdo vend tjetër përkatës i ndërmarrjes në të cilin hyjnë punëtorët brenda caqeve të punës së tyre.

VEPRA TË PËRKOHSHME Me vepër të përkohshme, kuptohet në ndërtim një strukturë ose një vepër, me kohëzgjatje të përkohshme, e cila nuk do të bëjë pjesë në strukturën e veprës së kryer. Janë vepra të përkohshme ato që janë të destinuara për sigurinë kolektive të punëtorëve në kantieret e ndërtimit.

VLERA LIMIT E PRAGUT (Threshold Limit Values - TLV) Është përqendrimi i një substance në ajër nën të cilën besohet se shumica e punëtorëve mund të mbetet e ekspozuar në mënyrë të përsëritur, ditë pas dite, pa efekte negative për shëndetin. TLV mund të shprehen në ppm (pjesë për milion) ose mg/m³.

VLERËSIMI I RREZIQEVE Është vlerësimi global dhe i dokumentuar i të gjitha rreziqeve të mundshme për punëtorët në vendin e punës. Ka qëllim të përpunojë masat e duhura për përmirësimin e kushteve të shëndetit dhe të sigurisë së punëtorit.

NORMATIVA E REFERIMIT

D.Lgs. 81/08; Dekreti 37 i 22/01/2008; D. Lgs. 626/1994; D.Lgs. 21/2008; L. 247/2007;

D.Lgs 257/2006; D.lgs. 66/2000: Realizimi i direktivës 97/42/BE dhe 1999/38/BE në fushën e mbrojtjes së punëtorëve kundra rreziqeve me prejardhje nga ekspozimi ndaj agjentëve kancerogjen gjatë punës;

D.Iv 25/2002: realizimi i direktivës 98/24/BE mbi mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve kundra rreziqeve me prejardhje nga agjentët kimikë gjatë punës;

D.M. 26 shkurt 2004: përcaktimi i një liste të vlerave limite indikative të ekspozimit profesional ndaj agjentëve kimikë.

Nën kujdesin e

***Departamenti i Zjarrfikësve të Ndihmës Publike dhe të Mbrojtjes Civile
Zyra e Kabinetit të Kryetarit të Departamentit - Komunikimi i Jashtëm***

Shtypur në Romë nga Rodorigo Editore - Maj 2012

